



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.06.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj– Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Senida Mesi, Edlira Hyseni, Artemis Dralo (Malo), Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Reme Lala, Artur Roshi dhe Krenar Ryci.

Mungojnë:

Nikolin Staka, Ervin Bushati dhe Vullnet Sinaj,

Të ftuar:

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Elvis Koçi- Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave

Artur Kala- Kryeadministrator i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Agim Muslia- Drejtor pranë Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave

Mikeljan Shkalla- Specialist pranë Parandalimit të Pastrimit të Parave

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Ne do të bëjmë rekomandime të kësaj natyre, prandaj dua që komisioni të fokusohet.

Në nenin 1, pika 2, rekomandohet të jepet përkufizim, përcaktim i qartë dhe shterues i personave të lidhur në marrëdhëniet e ngushta pune dhe biznesi. Po në këtë pikë rekomandohet që të shikohet afati 5-vjeçar i konsiderimit si persona të ekspozuar politikisht, bazuar edhe standardin e FATF-it. Në pikën 9 rekomandohet që fjalia e parë e paragrafit 25 riformulohet me këtë përmbajtje: “Mjet ose mjet virtual është pasqyrimi digjital i një vlere që mund të tregtohet apo transformohet në formë digjitale, si dhe mund të përdoret për qëllime pagesash ose investimesh, duke përfshirë, por pa u kufizuar te kriptomonedha”. Pas pikës 29 rekomandohet të shtohet pika 30 dhe 31, ku të jepet respektivisht përkufizimi i termit “kujdestar, financiar dhe vigjilencë e thjeshtësuar”. Në nenin 2 të projektligjit rekomandohen këto ndryshime: pika 1 riformulohet si më poshtë: pjesa hyrëse e germës “gj” riformulohet me këtë përmbajtje, pika 2 hiqet. Në nenin 5 të projektligjit rekomandohet që në pikën 1, germa “c”, nënndarja 8 të saktësohet termi “në mënyrë efektive”. Te pika 1 e nenit është shtuar pika 4\2, ku rekomandohet të rishikohet referenca ligjore, që ka të bëjë me direktivën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kanë si definicion, sepse na e sqaruan.

Në nenin 5 të projektligjit rekomandohet që në pikën 1, germa “c”, nënndarja 3, të saktësohet termi “Në mënyrë efektive”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kemi pas pikës 29, rekomandohet të shtohet pika 30, ku të jepet respektivisht përkufizimi i termit “Kujdestar financiar dhe vigjilencë e thjeshtësuar”.

Neni 11, pika 7, është rekomanduar që fjala “vëmendje e veçantë” të zëvendësohet me fjalët “vigjilencë e zgjeruar”.

Në nenin 14 të projektligjit rekomandohet të vlerësohet ruajtja e balancës mes cenimit të së drejtës dhe përdorimit e gëzimit lirisht të pronës dhe të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor të individit me atë të interesit publik.

Neni 20 rekomandohet të formulohet sipas përmbajtjes së mëposhtme, pas nenit 17 shtohet neni 17\1 “Deklarimet në kufi” shtohet me këtë përmbajtje “Çdo person, i cili hyn ose largohet në/nga territori i Republikës së Shqipërisë është i detyruar të deklarojë shumat në të holla, çdo lloj instrumenti të negociueshëm të mbajtësit, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga shuma 10 000 euro ose kundërvlera e saj në

monedha të tjera, qëllimin e mbartjes së tyre, si dhe dokumente justifikuese përkatëse”. Sipas pikës 1 të këtij neni, detyrim për deklarim e kanë edhe përfaqësuesit e personave që hyjnë ose largohen me mjete, kur këto transportohen nëpërmjet shërbimit të kontejnerëve apo atij postar. Autoritetet doganore...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Mungesë regjistrimi)

Artur Kala – Pjesa e sekuestrimit është te Kodi Penal dhe për momentin nuk duam ta prekim.

Arben Ahmetaj – Pse e keni shkruar këtu?

Artur Kala – Ne duam të vëmë gjobë në rastet kur nuk trajtohet si vepër penale.

Arben Ahmetaj – Referojuni vetëm gjobës, sepse vepra penale ka procedurë tjetër.

Artur Kala – Dakord.

(Mungesë regjistrimi)

Arben Ahmetaj – Gjobat janë: 5% për herë të parë, 10 % për herë të dytë, 30% për herë të tretë; për vlera ekuivalenti gjithmonë është 10% për herë të parë, 20 % për herë të dytë dhe 40% për herë të tretë; për vlera mbi ekuivalentin është 15%, 30% dhe 50%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë të domosdoshme. Imagjinoni që dikush të marrë para në çantë dhe nuk i deklaron, automatikisht është pastrim parash. Kur ke dokumente justifikuese që nuk e ke deklaruar shumën është histori tjetër, por kur ti kalon shuma të kësaj natyre, është problematikë tjetër. Pastaj është Kodi Penal që e trajton si vepër penale.

Senida Mesi – Lidhur me vlerat, pse duhet të referohemi në ligj me euro dhe jo me lekë? Ky është një ligj shqiptar i Republikës së Shqipërisë.

Arben Ahmetaj – Kundërvlefta në lekë e 10 mijë eurove...

(Mungesë regjistrimi)

Senida Mesi – Jam dakord, por pse në ligjin e Shqipërisë ne duhet t’i referohemi një vlerë në euro për sa kohë që monedha jonë vendase është në lekë?

(Mungesë regjistrimi)

Kur përmendet gjoba 5%, 10% apo 30%, 5%-shi i kujt merret si referencë?,

Arben Ahmetaj – 5%-shi i vlerës.

Senida Mesi – A duhet t’i shkruajmë këto në ligj, apo i mirëkuptojmë?

(Mungesë regjistrimi)

Artur Kala- Është çështje praktikiteti dhe nuk e dimë dot nëse e bëjmë fushatën e këtij limiti të rritur në kohë dhe këtyre gjobave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Mungesë regjistrimi)

Arben Ahmetaj – Kush është dakord me nenin 1, bashkë me rekomandimet e bëra?

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me radhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duro pak.

Nenet 2, 3 dhe 4 i kemi votuar.

Kalojmë te neni 5. Kush është dakord me nenin 5, bashkë me rekomandimet e bëra?

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 9. Kush është dakord me nenin 9, me rekomandimet e bëra? Pro?

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Mungesë regjistrimi).

Arben Ahmetaj – Neni 11. Kush është pro me nenin 11, bashkë me rekomandimet?

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Kush është dakord me nenin 12, bashkë me rekomandimet e bëra? Kundër?

Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Kush është dakord me nenin 13, bashkë me rekomandimet e bëra? Kundër?

Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15. Kush është pro neni 15, bashkë me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18. Kush është dakord me nenin 18, bashkë me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 19. Kush është pro nenit 19, bashkë me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 20. Kush është pro nenit 20, bashkë me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 21. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 22. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 23. Kush është pro nenit 23, bashkë me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 24. Kush është pro, bashkë me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 25. Kush është pro, bashkë me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 26. Kush është pro, bashkë me rekomandimet....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Senida Mesi – Te neni 24 thuhet: “Komiteti drejtohet nga Kryeministri dhe në përbërje ka ministrin për Europën, ministrin për Financën....”, unë them që duhet ndjekur e njëjta logjikë që kemi ndjekur dhe të thuhet: “Ministrin përgjegjës për...”

Arben Ahmetaj – E saktë.

Atëherë, do të bëjmë një rekomandim për gjrobat. Dua të sugjeroj që lidhur me rekomandimet për gjrobat të mbajmë rekomandimet e sjella nga ministria. Pse?! Sepse pastrimi i parave nuk është si evazoni dhe shkelja fiskale, por ka mbrapa deri financim terrorizmi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ligji i mendon të gjitha. Kështu që....

(Mungesë incizimi)

Artur Roshi –Kur kanë parashikuar rekomandimet, përfaqësuesit e ministrisë kanë menduar si hetues, por duhet të dilnin jashtë këtyre koncepteve. Ju duhet të ndani shkeljet administrative nga koncepti i hetimit. Hetimi për shkeljet e ligjit, bëhet nga dikush tjetër. Për shembull, diapazoni nga 100 mijë deri në 6 milionë, nuk ka sens. Duket sikur keni hapur

rrjetën, si dikur që, kur bashkëpunojë me partinë të hiqte njollën partia, të njëjtën gjë bëni juve me pastrimin e parave. Pra, ai që bashkëpunon...

Arben Ahmetaj – Nuk prish punë. Unë them që ta shtojmë si rekomandim rishikimin e gjobave për komisionin përgjegjës. Pastaj komisioni përgjegjës le të vendosi vetë, sepse ai është komisioni përgjegjës dhe mund t'i bëjë rekomandim Kuvendit. Ajo që thotë zoti Roshi ka një logjikë, që nga 100 mijë deri në 6 milionë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu, po t'ju pyes pse keni ikur nga 100 mijë në 6 milionë, nuk do të më jepnit racionalen. Megjithatë, ne nuk do të ndalojmë në këtë diskutim, do të marrim parasysh rekomandimin që japin zoti Roshi dhe deputetë të tjerë të komisionit. Shtojeni te rekomandimet që të kalojë neni me rishikim të gjobave.

Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E drejtë, rishikim në ulje.

E votojmë nenin 26 me këtë rekomandim.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 27. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Hyrja në fuqi. ne i rekomandojmë komisionit, më pas Elvisi do të mbajë qëndrim, sepse mund të ketë të drejtë dhe nuk duam t'i hyjmë logjikës.

Urdhëroni!

Antoneta Dhima – Zoti kryetar, në nenin 20, pika 5, thuhet: Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit të Ekonomisë dhe Financave të dhënat tatimore...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj - Jo, sepse ka vendosur një detyrim specifik.

Ajo është kërkesë specifike e ligjit vetëm për atë nen.

Antoneta Dhima - Vetëm për atë nen?

Arben Ahmetaj – Po.

Antoneta Dhima - Për shembull, në nenin 20 thuhet: "Fillojnë të zbatohen më 1 janar 2020".

Arben Ahmetaj – Ashtu siç thamë, zoti Koçi ka një qëndrim që më tingëllon racional.

Antoneta Dhima – Mos duhet të jenë bashkë?

Arben Ahmetaj – Jo, hyrja në fuqi e një gjëje dhe detajimi i akteve janë dy gjëra të ndryshme. Do të mbaj qëndrim Komisioni i Ligjeve për sa ne referuam, kështu që ne vetëm bëjmë rekomandim.

Neni 28. Kush është dakord me rekomandimin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Sipas asaj që vendosëm, rekomandimet i kalojnë komisionit përgjegjës.

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 06.06.2019, ora 12.30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Senida Mesi, Edlira Hyseni, Artemis Dralo (Malo), Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Reme Lala, Artur Roshi dhe Krenar Ryci.

Mungojnë:

Nikolin Staka, Ervin Bushati dhe Vullnet Sinaj.

Të ftuar:

Elton Haxhi – zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Elvis Koci – Drejtor i Përgjithshëm i DPPP-së

Artur Kala - Kryeadministrator i AASK-së

Agim Muslia - Drejtor pranë DPPP-së

Mikeljan Shkalla - Specialist pranë DPPP-së

Arben Ahmetaj – Vazhdojmë me projektligjin tjetër “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”.

Relatorja të kaloi me relatimin e ligjit. Më pas të kalojmë me zëvendësministrin ose me drejtorin, në qoftë se ka ndonjë pyetje.

Urdhëroni!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara” është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Ky projektligj synon ngritjen në një nivel më të lartë të të gjithë procesit aktual të administrimit të pasurive, duke vendosur në themele ligjore procedurën që ndjek Agjencia e Administrimit të Pasurive të Konfiskuara dhe të Sekuestruara që nga momenti i ekzekutimit të vendimit të sekuestros me marrjen në dorëzim të pasurive, duke vijuar më pas me menaxhimin e tyre, sipas mënyrave dhe formave specifike në varësi të llojit të pasurisë, duke mbyllur qarkun e administrimit me anë të procesit të destinimit përfundimtar të pasurive që konfiskohen.

Gjithashtu, synon krijimin e mekanizmave ligjorë, për të menaxhuar në mënyrë efektive pasuritë e ngrira dhe të konfiskuara në pritje të një vendimi të formës së prerë, duke adresuar kështu zbatimin e nenit 60 të konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit dhe nenit 6 të konventës së Varshavës, që konsistojnë në dhënien e kompetencës ndaj agjencisë për shitjen e pasurive të luajtshme, të cilat prishen, amortizohen apo u bie vlera shpejt qysh në fazën e sekuestrimit, duke mos pritur vendimin përfundimtar të konfiskimit.

Gjithashtu, synon krijimin e një zyre qendrore kombëtare, si nevojë për administrimin e pasurive të konfiskuara dhe të sekuestruara, e cila vjen si një detyrim, sipas të cilit shtetet anëtare i nënshtrohen vlerësimit të *MONEYVAL-it* për qëllime të administrimit të pasurive që cilësohen të vështira.

Për sa përket pjesës së efekteve financiare të projektligjit, miratimi i projektligjit do të shoqërohet me kosto financiare shtesë për buxhetin shtetit për vitin 2019 dhe në vazhdim. Kostot financiare do të konsistojnë në miratimin e strukturës së re; në shtimin e punonjësve nga 8 në 19 punonjës; në zërin paga dhe sigurime shoqërore, si edhe shpenzime operative dhe investime nevojë për zyra. Gjithsej në masën rreth 31 milionë lekë, ndërsa për vitet 2020-2021 në masën 25 milionë lekë. Si struktura përgjegjëse për zbatimin e këtij projektligji janë përcaktuar Ministria Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Me disa sugjerime për komisionin përgjegjës, i ftoj anëtarët e komisionit ta miratojnë atë. Sugjerimet konsistojnë që në pjesën e parë të rekomandimit të mundësohet shmangia e referencave konkrete ligjore, duke i zëvendësuar ato me përcaktime përgjithëse. Për shembull, referenca e ligjit nr. 10192 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, të ndryshuar”, të zëvendësohet me përcaktimin, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit. Kështu, rekomandohet të veprohet edhe për referencat e tjera ligjore gjatë gjithë projektligjit.

Së dyti, neni 6, pika 4, i projektligjit rekomandohet të riformulohet me këtë përmbajtje: “Kriteret profesionale, si edhe ato për autorizimin dhe/ose kontraktimin e personelit të jashtëm, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për Financat dhe Ekonominë”.

Në nenin 10 të projektligjit rekomandohet të përcaktohen kriteret përzgjedhjes, si edhe organi që emëron cakton administratorin koordinator.

Rekomandohet të rishikohet në tërësi neni 11, pika 3, për të përcaktuar:

a) Si vijojnë marrëdhëniet e punës së administratorit të pasurive të sekuestruara që janë punonjës të agjencisë/nëpunës civilë në rastet kur gjykata e ka shkarkuar atë nga funksioni për paaftësi ose për mos përmbushje të detyrës.

b) Saktësimin e procedurës së shkarkimit, kryesisht dhe me kërkesë.

Në nenin 36, pika 2 rekomandohet të hiqet dhe pika 1 të riformulohet me këtë përmbajtje: Pika 2 e nenit 34 të ligjit nr. 10 192 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, të ndryshuar”, si dhe çdo akt tjetër, që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji shfuqizohet”.

Më pas, kur të diskutojmë nen për nen, flasim edhe me përfaqësuesit e ministrisë për ato në të cilat bien dakord apo çfarë mund të ndryshojmë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Besoj se nuk ka nevojë ministria të mbajë qëndrim, pasi e ka mbajtur qëndrimin në relacion. Unë sugjeroj të lexoj, së pari, rekomandimet që edhe zonja Gjylameti i lexoi.

Dua dakordësinë tuaj, më pas të lexoj rekomandimet që do të japë komisioni dhe më pas ta kalojmë nen për nen. Në qoftë se keni ndonjë rekomandim specifik, ta shtojmë, në mënyrë që të jemi eficientë. A jeni dakord? Dakord.

Po lexoj rekomandimet dhe më pas shërbimet e Kuvendit të kenë parasysh rekomandimet që mund të shtojnë deputetët gjatë rrugës.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat i rekomandon komisionit përgjegjës, sa më poshtë vijon: “Rekomandohet të mundësohet heqja e shmangieve e referencave konkrete-ligjore, duke i zëvendësuar ato me përcaktime përgjithësuese, si, për shembull, referenca në ligjin nr. 10 192, datë 31.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, të ndryshuar”, të zëvendësohet me përcaktimin “Sipas legjislacionit në fuqi që rregullon parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit”. Kështu rekomandohet të veprohet edhe për referencat e tjera ligjore gjatë gjithë projektligjit. Gjithsesi, Komisioni i Ligjeve do të mbajë qëndrimin e tij.

Ashtu siç e tha edhe zonja Gjylameti, nenin 6, pika 4, i projektligjit rekomandohet të riformulohet me këtë përmbajtje: “Kriteret profesionale, si edhe ato për autorizimin dhe/ose kontraktimin e personelit të jashtëm përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat”.

Rekomandohet të rishikohet në tërësi neni 11, pika 3, për të përcaktuar:

a) Si vijojnë marrëdhëniet e punës së administratorit të pasurive të sekuestruara që janë punonjës të agjencisë/nëpunës civilë në rastet kur gjykata e ka shkarkuar atë nga funksioni për paaftësi ose për mospërmbushje të detyrës.

b) Saktësimin e procedurës së shkarkimit, kryesisht dhe me kërkesë, pra kjo të rishikohet. Gjithsesi, Komisioni i Ligjeve le ta shikojë.

Në nenin 36, pika 2 rekomandohet të hiqet dhe pika 1 të riformulohet me këtë përmbajtje: pika 2 e nenit 34 të ligjit nr. 10 192 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, të ndryshuar”, si dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji shfuqizohet”. Apo jo? Shikojeni me Komisionin e Ligjeve. Ne do t’jua dërgojmë me shkrim dhe u kërkoj deputetëve ta votojmë në parim dhe më pas të kalojmë nen për nen.

Kush është dakord me ligjin edhe me rekomandimet në parim? Kundër? Abstenim?

Miratohet projektligji në parim.

Fillojmë me votimin nen për nen. Për procedurë, unë do të kaloj aty ku ka rekomandime dhe aty ku nuk ka. Nëse do të keni ndonjë rekomandim specifik në ndonjë nen, do t’ju lutesha të ndërhyjnë në nenin përkatës dhe të sillni rekomandimin që keni.

Neni 1 “Objekti”.

Kush është dakord me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Kush është dakord me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Dua të më ndërhyini, në qoftë se keni rekomandime. Pra, gjatë procedurës, më thoni, në qoftë se keni rekomandime të tjera.

Neni 3. Kush është dakord me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet me të gjitha rekomandimet që lexova.

Ju lutem, ndërhyini kur të keni rekomandime të reja!

Neni 4 “Përkufizimet”.

Kush është dakord me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5 “Parimet e përgjithshme”.

Kush është dakord me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kreu II, neni 6 “Organizimi dhe funksionimi”.

Kush është dakord me rekomandimet?

Urdhëroni!

Antoneta Dhima – Në relacionin që lexoi relatorja dhe relacionin që kemi përpara numri nga 8 shkon 19. Pra, bëhet fjalë për personelin definitiv apo edhe për personelin jashtëm?

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Kush është dakord me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8 “Kompetencat e përgjegjësisë”.

Kush është dakord me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9 “Kryeadministratori”.

Kush është dakord me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10 “Administratori koordinator”.

Kush është dakord me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11 “Administratori i pasurisë së sekuestruar”.

Kush është dakord me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12 “Administratori i pasurisë së bllokuar dhe të sekuestruar më urdhër administrativ”.

Kush është dakord me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Kush është dakord me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Kush është dakord me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15 “Raportimi”.

Kush është dakord me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16. Kush është dakord me rekomandimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 19. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 20. Gjithmonë me rekomandimet që keni lexuar ose që do të bëhen nga deputetët. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 21. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 22. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Antoneta Dhima – Zoti kryetar, kam një pyetje. Në përgjithësi te nenet 22 dhe 23 u kërkohet institucioneve përkatëse. A mund të shpreheni se cilat janë këto institucione?

Arben Ahmetaj – Në fakt, sipas rastit.

Urdhëroni, zoti Artur!

Artur Kala – Varet nga institucionet, domethënë, institucionet e ndryshme, me të cilat bashkëpunon agjencia dhe nga lloji i pasurisë, që nga Drejtoria e Përgjithshme e Hipotekave, prokuroria, policia. Domethënë, varet nga lloji i pasurisë dhe nga vendimmarrja, pra është sipas rastit.

Arben Ahmetaj – Pra, sipas rastit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndalojnë ecurinë e biznesit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, patjetër administrohen atje ku janë.

(Mungesë regjistrimi)

Pra, nuk mund të cenojnë vazhdueshmërinë e biznesit, ndërkohë që biznesi monitorohet, sekuestrohet apo administrohet në bazë të neneve të mëparshme.

Xhevit Bushaj – Po kur kjo pasuri është gjë e gjallë e sekuestruar si i bëhet?

Artur Kala – Një nga risitë që sjellim në këtë ligj, pra ajo që synojmë të bëjmë, është shitja në fazën e sekuestros të pasurive të luajtshme, kryesisht janë makina dhe gjë e gjallë, që aktualisht i kemi në Fier. Ne i mbajmë në administrim dhe i kërkojmë gjykatës shitjen. Në fazën e sekuestros, ngurtësohen lekët. Nëse ia revokohet pasuria, ne i kthejmë lekët. Përndryshe, nëse i sekuestrohen i kalojmë buxhetit të shtetit. Ky është një sugjerim i ekspertëve, që e realizojmë me këtë ligj.

Arben Ahmetaj – Në rregull.

Për ato pjesë të pasurisë, siç iu referua Xheviti, praktikisht procedura ka avancuar në momentin e sekuestros, pra dikur ishte konfiskim, kurse tani është sekuestro dhe, nëse konfiskimi realizohet nëpërmjet procesit gjyqësor, në fund ato ngelen në buxhetin e shtetit, nëse rrezohet sekuestro, i rikthehen.

Në rregull.

Neni 22. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 23. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 24. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 25. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 26. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 27. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 28. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 29. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(I referohemi gjithmonë rekomandimeve që kemi dhënë.)

Neni 30. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 31. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 32. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 33.

Senida Mesi – Në nenin 33, pika 1, thuhet që duhet të krijohet një regjistër elektronik i pasurive të sekuestruara, të konfiskuara, por nuk ka një afat kohor për krijimin e këtij ligji, në mënyrë që edhe ne të kemi fuqinë monitoruese për zbatimin e ligjit.

Arben Ahmetaj – Artur, sa kohë ju duhet?

Artur Kala – Fatmirësisht, në momentin që ne nisëm të hartojmë këtë projektligj, na u miratua edhe regjistri elektronik dhe jemi në përfundim të këtij procesi. Paralelisht, me miratimin e ligjit dhe me marrjen në përgjegjësi administrimi të të gjitha pasurive me prejardhje kriminale, synojmë të kemi edhe statistika kombëtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ju mjafton koha deri në fund të këtij viti?

Artur Kala - Patjetër. Besoj se do të mbarojmë më shpejt.

Arben Ahmetaj – Gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit. *(Shënojeni në rekomandim)*

Neni 33, me rekomandimin gjashtë muaj pas aprovimit të ligjit, që përmendi zonja Mesi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 34.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 35.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 36.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 37.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E votojmë ligjin në tërësi bashkë me rekomandimet.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit, zoti zëvendësministër, zoti drejtor, zoti kryeadministrator!

Ishte kënaqësi dhe do të shihemi së shpejti!

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 6.6.2019, ora **13:50**

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS)”.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Senida Mesi, Edlira Hyseni, Artemis Dralo (Malo), Blerina Gjylameti, Vullnet Sinaj, Artur Roshi, Krenar Ryci, Ardit Konomi

Mungojnë:

Nikolin Staka, Ervin Bushati, Anastas Angjeli, Reme Lala.

Të ftuar:

Elton Haxhi –Zëvendësministër

Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Doriana Toro, Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arben Ahmetaj - Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS)”.

Projektligji është paraqitur për shqyrtim nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimit të nenit 83. Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, KREU II, “Marrëveshjet ndërkombëtare”. Projektligji ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash. Notën e përgatita unë, por nuk arrita ta firmosja unë.

Në maj të vitit 2016 dhe përsëri në mars 2018 Shqipëria mori ftesë nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) për t’iu bashkuar kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (projekti BEPS), i cili u diktua si rezultat i krizës financiare dhe planifikimit agresiv tatimor.

Ky projekt ndërkombëtar dhe gjithëpërfshirës ka si synim arritjen e tre objektivave kryesorë:

1. Përforsim të koherencës së rregullave të tatimit mbi të ardhurat e korporatave në nivel ndërkombëtar.
2. Lidhjen e tatimit me përmbajtjen e aktiviteteve ekonomike të realizuara.
3. Përmirësim të transparencës.

Në dijeninë time të saktë i është paraqitur OECD-së në nëntor të vitit 2018 dhe, në mos gaboj, është firmosur para dy javëve, Niko.

Elton Haxhi— Para dy javësh firmosëm një nga masat e BEPS-it.

Arben Ahmetaj – Në veçanti për të gjitha vendet pjesëmarrëse ky projekt ofron:

- zhvillimin e standardeve në lidhje me çështjet e BEPS-së;
- rishikimin dhe implementimin e standardeve minimale nëpërmjet një sistemi efektiv monitorimi;
- një forum për vendet që të nxjerrin në pah sfidat në zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe të gjejnë zgjidhje të reja. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për vendet në zhvillim.
- lehtësimin e procesit të implementimit, duke ofruar orientim të mëtijshëm dhe suport për vendet në zhvillim, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve dhe drejtimin sipas

platformës së bashkëpunimit për tatimet, e ngritur kjo nga organizatat ndërkombëtare (IMF, OECD, UN dhe WB).

Për sa u përket efekteve financiare, ky projektligj parashikon shpenzime buxhetore pasi për bërjen palë të Republikës së Shqipërisë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi evazionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS) do të paguhet një kuotë anëtarësie prej 20 200 (njëzet mijë e dyqind) eurosh në vit, vlerë e cila do të rregullohet dhe me inflacionin vjetor përkatës, të përcaktuar nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.

Faleminderit!

Vazhdojmë me diskutimet në komision.

Ka ndonjë mendim? Nuk ka.

E votojmë ligjin në parim.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Besoj se anëtarët e komisionit e kanë lexuar marrëveshjen?

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Keni ndenjë pyetje për detajet e marrëveshjes? Nuk keni.

E votojmë në tërësi marrëveshjen dhe ligjin që e ratifikon atë.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Kjo marrëveshje do ta ndihmojë Ministrinë e Financave të marrë të gjitha masat e veta antievazion dhe të ndjekë standardet në vazhdimësi.

Faleminderit dhe mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti